

VENDIM
Nr. 86, datë 30.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT, CERTIFIKIMIT DHE TESTIMIT TË VARIETETEVE PËR FARAT E DRITHËRAVE¹

(Ndryshuar me VKM Nr. 319, datë 27.4.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 9, 14 pika 3, 15 pika 3, 16 pika 4, dhe 33 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farave të drithërave, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e paketimit dhe etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim, si dhe procedurën e testimit e provat krahasuese për kontrollin e farave të drithërave që vendosen në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE TË DRITHËRAVE

1. Kriteret që duhet të plotësojnë farat e drithërave për tregtim janë:

a) të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë e tyre sipas kërkesave të këtij vendimi;

b) të jenë të pajisura me certifikatën zyrtare, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) të jenë të paketuara dhe të etiketuara konform me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu;

ç) varieteti ose hibridi prej të cilit është prodhuar fara të jetë i regjistruar në katalogun kombëtar;

d) të plotësojnë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave të drithërave

2.1 Sipas prejardhjes, farat e drithërave ndahen në këto kategori:

a) fara parabazë;

b) fara bazë;

ç) riprodhimi i parë;

c) riprodhimi i dytë.

2.2 Farat e riprodhimit të parë dhe farat e riprodhimit të dytë hyjnë në kategorinë e farave të certifikuara.

2.3 Skemat e prodhimit të kategorive të farave të drithërave, sipas grupimit të bimëve të drithërave (bimë drithërash vetëpllenuese dhe bimë drithërash me pllenim të kryqëzuar), bëhen nën monitorimin dhe përgjegjësinë e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (në vazhdim ESHFF).

2.4 Identiteti i farave të drithërave është tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike, me qëllim për ta dalluar, në përdorim, një specie të caktuar nga speciet e tjera. Sipas këtij kriteri, farë drithërash do të konsiderohen farat që rrjedhin nga bimët:

¹Ky vendim është përafëruar pjesërisht me direktivën 66/402/KEE të Këshillit, datë 14 qershor 1966 "Për tregtimin e farave të drithërave"; numri CELEX 31966LO402, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 125, datë 11.7.1966, faqe 2298-2308.

a) Tërshëra e zhveshur	Avena nuda L. Avena nuda;
b) Tërshëra e zakonshme dhe tërshëra "bizantine"	Avena comune e avena bizantina;
c) Tërshëra e pyllit (forestiera)	Avena strigosa Schreb;
ç) Elbi	Hordeum vulgare L.;
d) Orizi	Oryza sativa L.;
dh) Thekra	Secale cereale L.;
e) Melekuqja	Sorghum bicolor (L.);
ë) Sorgumi sudanez	Sorghum sudanense;
f) "Gruri i butë"	Triticum aestivum;
g) "Gruri i fortë"	Triticum durum Desf;
gj) "Gruri spelta"	Triticum spelta L.;
h) Misri, përjashtuar misri për kokoshka dhe misri i ëmbël	Zea mais L. (Partim);
i) Sorgumi dyngjyrësh	Sorghum bicolor (L.);
j) Tritikalet, që rrjedhin nga kryqëzimi i një speciejë të gjinisë <i>triticum</i> me një specie të gjinisë <i>secale</i> .	

2.4.1 Farë drithërash do të konsiderohen, gjithashtu, edhe farat që prodhohen nga parcelat e mbjella me:

- a) varietet me pllenim të lirë, një varietet pak a shumë uniform dhe i qëndrueshëm;
- b) linja "inbrede", një linjë mjaft uniforme dhe e qëndrueshme, që arrihet si me anë të vetëpllenimit artificial e shoqëruar me seleksionim përgjatë shumë brezave pasardhës, ashtu dhe me veprime të ngjashme;
- c) farë hibrid i thjeshtë, që përfitohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet dy linjave "inbrede", të përcaktuar nga seleksioneri;
- ç) farë hibrid i dyfishtë, i cili përfitohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet dy hibridëve të thjeshtë, të përcaktuara nga seleksioneri;
- d) farë hibrid i trefishtë, që përfitohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet një linje "inbrede" dhe një hibridi të thjeshtë, të përcaktuar nga seleksioneri;
- dh) farë hibrid "top cross", që përfitohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet një linje "inbrede" apo një hibridi të thjeshtë dhe një varieteti me pllenim të lirë, të përcaktuar nga seleksioneri;
- e) farë hibrid ndërvarietor, që përfitohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet bimëve të farave bazë të dyja varieteteve me pllenim të lirë, të përcaktuar nga seleksioneri.

2.5 Cilësia e farave të drithërave përcaktohet nga këta tregues:

- a) Pastërtia e përgjithshme, që është përqindja e farave të pastra ndaj peshës së tyre të përgjithshme;
- b) Fuqia mbirëse, që është aftësia e farës së drithërave për të mbirë në kushte të caktuara dhe që përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vëna për mbirje;
- c) Energjia mbirëse, e cila është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar sipas ISTA-s (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave) dhe që shprehet në përqindje;
- ç) Lagështia, që është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara për t'u paketuar dhe për t'u tregtuar si material mbjellës.

2.6 Normat për treguesit cilësorë të farave të drithërave janë të përcaktuara në tabelën A të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Paketimi dhe etiketimi i farës së drithërave

3.1 Paketimi i "farës bazë" apo i "farës së certifikuar" të çdo kulture dhe lloji shoqërohet me dy lloje etiketash: etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare e lëshuar nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara e drithërave është certifikuar dhe kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Fara e drithërave të kategorive "fara bazë" dhe "fara e certifikuar" duhet të tregtohet vetëm në lote homogjene dhe të paketuara.

3.3 Paketimet e "farave bazë" dhe të "farave të certifikuar" të çdo kulture dhe lloji duhet të kryhen në mënyrë të tillë që, nëse hapen, mbyllja ose vetë paketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi

etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Ripaketimi i farës së drithërave bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik për verifikimin e cilësisë së farës, me kërkesë të furnizuesit. Nëse ripaketohet, ripaketimi dhe data e ripaketimit duhet të shënohen në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Paketat e “farave parabazë”, të “farave bazë” dhe të “farave të certifikuara” të çdo kulture dhe lloji duhet që:

a) të jenë të pajisura, në pjesën e jashtme, me një etiketë zyrtare, konform me kërkesat e përcaktuara në shtojcën IV të këtij vendimi, dhe në gjuhën shqipe.

b) të përmbajnë një dokument zyrtar të së njëjtës ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë, të paktën, kërkesat e përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të shkronjës “a” të shtojcës IV (I), bashkëlidhur këtij vendimi.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i “farës bazë” apo i “farës së certifikuar” të çdo lloji, përmban edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Kushtet në të cilat farat e shumëzuara nga riprodhimet e “farës parabazë” mund të tregtohen si “fara bazë”, “fara të certifikuara”, “fara të certifikuara të riprodhimit të parë” dhe “fara të certifikuara të riprodhimit të dytë” janë këto:

a) të jenë kontrolluara zyrtarisht nga autoriteti certifikues, në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e “farës bazë”;

b) të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) paketat duhet të kenë një etiketë zyrtare, ku të shënohen, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

i) autoriteti certifikues;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i vulosjes, ose

iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;

v) speciet, duke shënuar, të paktën, emrin botanik të tyre, që mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit;

vi) varieteti të shënohet, të paktën, me karaktere latine;

vii) të dhënat për farën “parabazë”;

viii) riprodhimi;

ix) të jetë e bardhë me një vijë diagonale vjollcë.

3.8 Çdo trajtim me plehrat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, që i është bërë “farave bazë” dhe “farave të certifikuara”, shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

III. CERTIFIKIMI I FARAVE TË DRITHËRAVE

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të farave të drithërave realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjektet publike apo private, sipas përcaktimit të kreut IX të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave të drithërave të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre është si më poshtë:

a) Për certifikimin e farave të drithërave pranë autoritetit certifikues, duhet të paraqiten këto dokumente:

i) kërkesa me shkrim për certifikimin e farës së drithërave;

ii) licenca përkatëse e lëshuar nga QKL-ja;

iii) aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimin e kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat e drithërave dhe modelit të dhënë në shtojcën V të këtij vendimi;

iv) certifikata e origjinës, që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

v) certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;

vi) aktaprobimi fushor;

vii) fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar

nga laboratori i miratuar nga ministri;

viii) etiketa e prodhuesit;

ix) deklarata e konformitetit.

b) Autoriteti certifikues ndjek këtë procedurë certifikimi:

i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës së drithërave që do të certifikohet, si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në katalogun kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e mësipërm, plotëson procesverbalin për "Verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës së drithërave";

ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim, në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të mësipërm;

iii) Gjatë vlerësimit të dosjes, duhet të mbahet parasysh që përmbajtja maksimale e lagështirës për "farat bazë" dhe "farat e certifikuar", të të gjitha llojeve, të jetë jo më shumë se 14%;

iv) Në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare, në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

v) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi, sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

vi) Elementet dhe kriteret e përmbajtjes së etiketës duhet të jenë sipas përcaktimeve të shkronjës "A" të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi;

vii) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr e plotësuar nga prodhuesi sasi të etiketës zyrtare.

1.3 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit dhe lëshimi i certifikatës zyrtare duhet të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.4 Nëse subjekti i autorizuar nga ESHFF-ja për kryerjen e procedurave të certifikimit nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar në nënpikën 1.3 të këtij kreu, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ESHFF-së.

1.5 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar në nënpikën 1.3, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

1.6 Forma, përmbajtja dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës për certifikim jepen në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kriteret e ruajtjes dhe marrja e mostrave të farës së drithërave për certifikim

2.1 Farat e drithërave duhet të mbahen në mjedise të përshtatshme, të cilat gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit të tyre sigurojnë temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë për farat e drithërave. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farave të drithërave. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratimin higjeno-sanitar, të lëshuar nga strukturat lokale të shëndetit publik, si dhe me certifikatë për DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), të lëshuar nga subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi. Farat e drithërave nuk duhet të mbahen në ruajtje më shumë se 3 (tre) vjet.

2.2 Fara e drithërave tregtohet si e tillë vetëm pasi të jetë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Gjatë përpunimit, farat e drithërave mund të dezinfektohen e peletohen me pesticide e lëndë kimike, ushqyese, kjo e shoqëruar me shënimin në etiketën përkatëse.

2.3 Furnizuesve të farave të drithërave u lejohet që, në mjediset e tyre, të përpunojnë, paketojnë dhe etiketojnë fara edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e farave të drithërave.

2.4 Procesi i analizës laboratorike të farave të drithërave, për certifikim, ushtrohet për:

a) lotin e farës, si një sasi e dhënë e farave të drithërave, e një riprodhimi dhe e një kategorie që ka një pastërti varietore;

b) mostrën e marrë në një ose në disa pika të lotit të farës;

c) kampionin fillestar, si një sasi e farave të drithërave që del nga përzierja e mostrave;

ç) kampionin mesatar, si një pjesë e kampionit fillestar;

d) provën si një pjesë e kampionit mesatar, sipas përcaktimeve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.5 Mostrat e farave për analizën e farave të drithërave, për qëllim certifikimi, duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar, në përputhje me metodat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2.6 Për ekzaminimin e farës së drithërave për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre përcaktohen në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. PROCEDURA DHE METODAT E TESTIMIT TË VARIETETEVE QË REGJISTROHEN NË KATALOGUN KOMBËTAR

(Shfuqizuar me VKM Nr. 319, datë 27.4.2016)

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha